

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6903
E mërkurë, 24 maj 2023
Çmimi 0.40 €

Migrimi, sfidë për shtetin e Kosovës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KDI THOTË SE PROJEKTLIGJI I RI PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME CENON INTEGRITETIN ZGJEDHOR.



Muajin e kaluar Komisioni ad-hoc për Reformë Zgjedhore përmylli punën njëvjeçare, që rezultoi me një draft të ri të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili është miratuar në parim dhe ka marrë mbështetjen e

subjekteve politike parlamentare. Mirëpo Instituti Demokratik i Kosovës (IKD) ka theksuar se projektligji i ri për zgjedhjet e përgjithshme cenon integritetin zgjedhor. Sipas KDI-së, projektligji që

do t'i paraqitet Kuvendit ka adresuar vetëm çështje të natyrës teknike që lidhen me administrimin e zgjedhjeve e të cilat ishin kërkuar vazhdimisht nga misionet e BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve

AKTUALE



XHAÇKA, HOMOLOGUT GREK: ÇËSHITJA 'BELERI' NUK DUHET TË NDIKOJË NË MARRËDHËNIET DYPALËSHE F.2

PËRFUNDON DËSHMINË DËSHMITARI I GJASHTË I SPECIALES F.5

SENATORËT AMERIKANË TAKOHEN EDHE ME LIDERËT E OPOZITËS F.3

EKONOMI



SINDIKALISTËT NË MAQEDONI, NË BETEJË ME QEVERINË PËR RUAJTJEN E 40 ORËVE PUNË NË JAVË F.8

ATK-ja KËRKON NGA SEKTORI I GASTRONOMISË DHE KËNGËTARËT T'I DEKLAROJNË DETYRIMET TATIMORE F.8

SPORT



ADEMI DHE RAMA PAJTOHEN PËR STADIUMIN E RI NË KRYEQYTET F.10



OSMANI PËR DIALOGUN: SERBIA PO ABUZON ME DIALOGUN QË TË KRIJOJË KRIZA TË REJA NË RAJONIN TONË

ÇITAKU PËR QEVERINË KURTI: PA ASNJË IDE KONKRETE SE SI TË NDIHMOHET QYTETARI



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Xhaçka, homologut grek: Çështja 'Beleri' nuk duhet të ndikojë në marrëdhëniet dypalëshe

BRUKSEL, 23 MAJ - Ministrja e Punëve të Jashtme e Shqipërisë, Olta Xhaçka, ka dhënë hollësi nga takimet e saj në Bruksel në kuadër të Këshillit të Punëve të Jashtme të Bashkimit Evropian. Qëllimi i takimit me ministrat e jashtëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian si dhe ministrat e Jashtëm të Ballkanit Perëndimor, sipas Xhaçkës, ishte thellimi i dialogut midis BE-së dhe Ballkanit për çështje të politikës së jashtme dhe të sigurisë në kuadrin e rëndësisë gjithnjë e më të madhe që BE-ja po na kushton në kontekstin aktual gjeopolitik. "Pata kënaqësinë të takohem me kolegët e mi, ministra të jashtëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian si dhe ministrat e jashtëm të Ballkanit Perëndimor, në kuadër të Këshillit të Punëve të Jashtme të Bashkimit Evropian. Qëllimi i takimit ishte

thellimi i dialogut midis BE-së dhe vendeve tona për çështje të politikës së jashtme dhe të sigurisë në kuadrin e rëndësisë gjithnjë e më të madhe që BE-ja po na kushton në kontekstin aktual gjeopolitik", ka thënë ajo. Xhaçka ka treguar se gjatë takimit me ministrin e Punëve të Jashtme të Greqisë, Nikos Dendias, ishte një mundësi e mirë për të diskutuar për kandidatin e koalicionit "Bashkë Fitojmë" për Himarë, Fredi Beleri, i cili fitoi zgjedhjet në këtë bashki, por që është në paraburgim nën dyshimin për blerje të votave dhe ka shtetësi edhe greke.

Ajo ka theksuar qartazi se kjo është një çështje gjyqësore që nuk duhet të ndikojë në faqen e re që kanë hapur në marrëdhëniet dypalëshe të dyja vendet. "Kjo nuk është as çështje e të Drejtave të Njeriut, as



politike, e jo më një çështje dypalëshe. Z. Beleri gëzon të njëjtat të drejta si çdo qytetar tjetër shqiptar dhe asnjë qytetar shqiptar nuk është mbi ligjin.

Blerja e votës është një shkelje e rëndë e ligjit tonë dhe çështja e tij tashmë është në gjykatë. E vetmja gjë që ne të gjithë mund të bëjmë është të presim me

durim që procesi të ecë në rrjedhën e tij dhe të mos paragjykojmë apo hamendësojmë atë", ka thënë Xhaçka.

Takimi Biden - McCarthy përfundon pa marrëveshje për tavanin e borxhit

UASHINGTON, 23 MAJ - Presidenti amerikan Joe Biden dhe kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy, nuk arritën marrëveshje të hënën për rritje të tavanit të borxhit prej 31.4 trilionë dollarësh të qeverisë amerikane vetëm 10 ditë përpara se një mospagesë e mundshme mund ta fundosë ekonominë amerikane. Megjithatë, të dy u zotuan t'i vazhdojnë bisedimet.

Presidenti demokrat dhe republikani kryesor në Kongres janë përballur me sfida në arritjen e një marrëveshjeje. McCarthy po ushtron presion mbi Shtëpinë e Bardhë për të rënë dakord për shkurtime e shpenzimeve në buxhetin federal, të cilin Bideni e konsideron si një kërkesë "ekstreme". Në të kundërtën, presidenti po mbron taksat e reja të vendosura që



republikanët tashmë i kanë refuzuar.

Të dyja palët theksuan nevojën për ta shmangur falimentimin me një marrëveshje dypartiake pas takimit të së hënës në

mbrëmje, dhe sinjalizuan se do të bisedonin rregullisht në ditët në vijim. "Ne përsëritëm edhe një herë se falimentimi nuk është opsion dhe mënyra e vetme për të ecur përpara është

në mirëbesim drejt një marrëveshjeje dypartiake", tha Bideni në një deklaratë pas takimit të cilin ai e quajti "produktiv".

McCarthy u tha gazetarëve pas

më shumë se një ore bisedimesh me Bidenin se negociatorët do t'i vazhdojnë përpjekjet për ta gjetur gjuhën e përbashkët. "Unë besoj se ne ende mund ta arrijmë [marrëveshjen]", tha McCarthy.

Ai nuk është i gatshëm ta marrë në konsideratë planin e Bidenit për ta ulur deficitin duke rritur taksat për të pasurit dhe duke mbyllur boshllëqet e taksave për industrinë e naftës dhe industrinë farmaceutike.

McCarthy tha se është i fokusuar në reduktimin e shpenzimeve në buxhetin federal për vitin 2024.

Demokratët dhe republikanët kanë afat deri më 1 qershor për ta rritur kufirin e vetëhuamarrjes së qeverisë, përndryshe do të rezultojë në një falimentim të paprecedentë të borxhit. Ekonomistët paralajmërojnë se mospagimi i borxhit mund të çojë në një recesion.

Asambleja e NATO-s i quan gjenocid krimet e Ruisë në Ukrainë

BRUKSEL, 23 MAJ - Asambleja Parlamentare e NATO-s ka votuar njëzëri të hënën për të shpallur krimet e Ruisë kundër Ukrainës gjenocid, duke shënuar "një fitore diplomatike për Kievin me pasoja më të gjera politike", tha Yehor Cherniev, kreu i delegacionit të Ukrainës në asambelën e mbledhur në Luksemburg. "Kjo është fitorja jonë diplomatike. Të gjitha kërkesat tona kryesore në

lidhje me tekstin përfundimtar të deklaratës janë marrë parasysh".

Deklarata përfshin mbështetjen për një gjykatë ndërkombëtare për krimet ruse të luftës, një zotim për ta ndihmuar Ukrainën ta arrijë fitoren, një angazhim për ta rikthyer integritetin territorial të Ukrainës, zbatimin e sanksioneve të mëtejshme dhe një program ndihme të ngjashme me Planin Marshall

për ta ndihmuar rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit.

Përmes një videofjalimi në mbrëmjen e së hënës, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky përsëriti deklaratën e Asamblesë Parlamentare të NATO-s. "Një njohje e qartë e krimeve të Ruisë kundër vendit tonë si gjenocid", tha ai, duke shtuar se kjo është baza e duhur edhe për organizatat e tjera ndërkombëtare.



Osmani për dialogun: Serbia po abuzon me dialogun që të krijojë kriza të reja në rajonin tonë



Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, duke folur për procesin e dialogut Kosovës - Serbi, ka theksuar se obligimet e dala nga marrëveshja e Ohrit duhet të zbatohen nga të dyja palët. Ajo ka theksuar se Kosova në këtë proces ka garanci nga ShBA-ja që mos të dilet jashtë kornizave që i përcakton sistemi ynë kushtetues. Osmani ka pohuar se Serbia është duke abuzuar me dialogun në mënyrë që të krijojë kriza të reja në rajonin tonë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 MAJ - Presidentja Vjosa Osmani në një deklaratë për medie ka folur për procesin e dialogut Kosovës - Serbi. Ajo ka theksuar se Kosova ka dhënë pëlqimin për një marrëveshje në Bruksel dhe aneksin në Ohër, e cila është e qartë sa iu përket obligimeve që dalin për të dyja palët. "Pra nuk ka obligime vetëm për një palë, Republikën e Kosovës. Për të gjitha ato obligime që dalin nga marrëveshja sa i përket Republikës së Kosovës, ne në asnjë moment nuk e kemi për qëllim që të ikim prej tyre, përkundrazi është me rëndësi që ato të zbatohen sa më parë që të jetë e mundur, por në

përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe gjithnjë duke pasur parasysh që mos të minohet funksionaliteti i brendshëm i shtetit tonë", ka thënë Osmani.

Ajo ka theksuar se Kosova në këtë proces ka garanci nga ShBA-ja. "Ne kemi garanci nga ShBA-të se ata nuk do të kërkojnë që ne të dalim jashtë kornizave që i përcakton sistemi ynë kushtetues dhe në asnjë moment nuk do të kërkojnë që të preket sovraniteti dhe integriteti territorial. Do të punojmë së bashku me ta. Duhet ta kemi parasysh se i gjithë ky proces nuk varet vetëm nga Kosova", ka pohuar presidentja Osmani, duke shtuar se Serbia deri më tani nuk ka treguar konstruktivitet.

"Ka dëshmuar se nuk është e interesuar për paqe dhe stabilitet në rajon, por që të abuzojë me dialogun në mënyrë që të krijojë kriza të reja në rajonin tonë", është shprehur presidentja Osmani, duke shtuar se në këtë rast kemi të bëjmë me një fqinj i cili është i interesuar për destruktivitet dhe për kriza. "Në tërë këtë situatë duhet të manovrojmë në një mënyrë që në njërin anë të mbrohen paqja dhe stabiliteti që është arritur, në anën tjetër të bëjmë hapa përpara sa i përket dialogut. Nëse gjithçka do të varej nga Kosova, obligimet do të zbatoheshin para verës. Pra, marrëveshja në tërësi varet nga të dyja palët", është shprehur presidentja Osmani.

I dërguari i posaçëm i Shteteve

të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka vlerësuar se marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit është një "arritje e madhe" dhe se ajo paraqet një "hap historik përpara" në zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Në një intervistë për agjencinë Mina, Escobar tha se "nuk sheh arsye" pse marrëveshja për çështjet e mbetura të mos mund të arrihet deri në fund të verës. Siç tha ai, në Serbi ka disa elemente që duhet të plotësohen sa i përket njohjes së targave të veturave, letërnjoftimeve dhe disa gjërave të tjera. "Edhe nga Kosova pritet të formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Më falni, kjo nuk është pritje! Është obligim", ka thënë Eskobari.

Ai ka pohuar se Shtetet e Bashkuara duan që këto procese të zhvillohen sa më shpejt që të jetë e mundur. "Nuk shoh asnjë arsye pse të mos mund të përfundojë deri në

fund të verës", ka deklaruar Escobar.

Një ditë më parë shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, pas takimit në Bruksel të ministrave të Punëve të Jashtme nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, u ka bërë thirrje palëve t'i zbatojnë të gjitha obligimet që dalin nga ky proces dhe t'u japin fund tensioneve dhe deklaratave e sjelljeve provokuese. Ai ka thënë se rruga drejt integritetit evropian shkon përmes bashkëpunimit dhe ndërtimit të fqinjësisë së mirë.

Kosova dhe Serbia më 27 shkurt në Bruksel arritën marrëveshje për normalizim të raporteve, ndërkaq më 18 mars në Ohër u pajtuan për aneksin e zbatimit të saj. Por deri më sot asnjë veprim i zbatimit të saj në praktikë nuk është marrë dhe dialogu ka ngecur. Kosova po kërkon zbatimin e plotë të marrëveshjes, ndërkaq Serbia zbatimin e Asociacionit. Përfaqësuesit ndërkombëtarë po bëjnë thirrje që të dyja palët të ecin përpara në këtë proces.

Senatorët amerikanë takohen edhe me liderët e opozitës

PRISHTINË, 23 MAJ - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), një ditë pas vizitës të dy senatorëve amerikanë, Chris Murphy dhe Gary Peters, në Kosovë, ka njoftuar për takimet që ata kanë pasur të hënën në Prishtinë.

Sipas fotografive të publikuara në "Facebook" nga Ambasada Amerikane, senatorët nuk janë takuar vetëm me presidenten

Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti, por edhe me opozitarët. Senatorët amerikanë së bashku me ambasadorin Jeff Hovenier janë takuar me Memli Krasniqin, Lumir Abdixhikun dhe Ramush Haradinajn. "Ishte një gjë e mrekullueshme t'i mirëpresim senatorët Murphy dhe Peters në Kosovë! Gjatë vizitës së tyre delegacioni u takua me liderët

kosovarë, anëtarë të shoqërisë civile dhe përfaqësues të medie", ka njoftuar Ambasada e Amerikës.

Dy senatorët në Kongresin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Chris Murphy dhe Gary Peters, të hënën kanë konfirmuar se temë diskutimi në mes tyre dhe kryeministrin Albin Kurti ka qenë çështja e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.





KDI thotë se projektligji i ri për zgjedhjet e përgjithshme cenon integritetin zgjedhor

Muajin e kaluar Komisioni ad-hoc për Reformë Zgjedhore përmbylli punën njëvjeçare, që rezultoi me një draft të ri të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili është miratuar në parim dhe ka marrë mbështetjen e subjekteve politike parlamentare. Mirëpo Instituti Demokratik i Kosovës (IKD) ka theksuar se projektligji i ri për zgjedhjet e përgjithshme cenon integritetin zgjedhor. Sipas KDI-së, projektligji që do t'i paraqitet Kuvendit ka adresuar vetëm çështje të natyrës teknike që lidhen me administrimin e zgjedhjeve e të cilat ishin kërkuar vazhdimisht nga misionet e BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 23 maj - Muajin e kaluar Komisioni ad-hoc për Reformë Zgjedhore përmbylli punën njëvjeçare, që rezultoi me një draft të ri të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, i cili është miratuar në parim. Ky projektligj reflekton një konsensus të plotë mes subjekteve politike parlamentare të cilat kanë treguar pajtim edhe për shqyrtimin e përsheptuar të tij. Instituti Demokratik i Kosovës (IKD) ka theksuar se edhe pse pritet ishin që komisioni ta trajtonte reformën zgjedhore në mënyrë më përmbajtësore, pra në përputhje me vetë emrin e tij, projektligji që do t'i paraqitet Kuvendit ka adresuar vetëm çështje të natyrës teknike që lidhen me administrimin e

zgjedhjeve e të cilat ishin kërkuar vazhdimisht nga misionet e BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve. "Shumë elementë, që janë në interes të garantimit të përfaqësimit sa më të drejtë dhe avancimit të demokracisë, janë lënë anash përkundër nevojës dhe rëndësisë që ato kanë. Në fakt, kjo 'reformë', përtej ndryshimeve kozmetike, i ka shërbyer shumë më tepër akomodimit të interesave të ngushta të subjekteve politike, veçanërisht lidhur integritetin e procesit zgjedhor - ku është shënuar regres serioz.

Kështu, subjektet politike janë pajtuar që me këtë projektligj ta ulin standardin për përshatshmërinë juridike të kandidatëve, që në praktikë ua mundëson kandidimin edhe atyre që janë të dënuar me kusht apo me gjobë për vepra penale.

Ndaj lista zgjedhore do të vlejë vetëm ndaj personave të dënuar me burgim efektiv prej së paku një viti apo atyre me dënime plotësuese. Duke qenë se sistemi ynë i drejtësisë shquhet për politikë të ulët ndëshkimore - ku vetëm gjatë dy vjetëve të fundit 2/3 e veprave penale për korrupsion kanë përfunduar me dënim me kusht apo me gjobë - projektligji i ri i hap rrugë kandidimit, rrjedhimisht zgjedhjes së personave që kanë probleme me ligjin", theksohet në komunikatën e KDI-së.

KDI-ja ka rekomanduar që kandidimi t'u mohohet të gjithë personave të dënuar me vendim të formës së prerë pavarësisht llojit dhe lartësisë së dënimit për veprat e rënda penale të përcaktuara sipas nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ku, mes të tjerash, përpos veprave të dënueshme me mbi 10 vjet burgim, përfshihen edhe veprat penale të korrupsionit, veprat e cenimit të të drejtave zgjedhore dhe kundër integritetit të zgjedhjeve, krimin e organizuar. "Me projektligjin e ri është ndryshuar edhe votimi preferencial, nga pesë kandidatë sa ka qenë deri më tani, në 10 sa ka qenë në zgjedhjet e vitit 2007. Bazuar në përvojën tonë në vëzhgimin e zgjedhjeve dhe edukimin e votuesve, dhënia e mundësisë për votuesit që të votojnë deri në 10 kandidatë nuk kontribuon në përfaqësim më të

mirë apo më kualitativ në Kuvend. Për më keq, rritja e votës preferenciale ka ndikim negativ edhe në administrimin e zgjedhjeve. Përveç dyfishimit të kohës që duhet për numërimin e këtyre votave, rritet potenciali i manipulimit të vullnetit qytetar nga ana e komisionarëve, posaçërisht në rastet kur votuesit potencialisht do të shënojnë më pak se 10 kandidatë", thuhet në këtë komunikatë.

Duke analizuar trendet e deritanishëm të votimit, KDI thekson se del se votuesit zakonisht nuk votojnë as pesë kandidatë sa ua mundëson sistemi aktualisht. "Në tri palë zgjedhjet e fundit parlamentare (2021, 2019 dhe 2017) votuesit kanë votuar mesatarisht katër kandidatë, kurse edhe në zgjedhjet e vitit 2007, kur kemi pasur votim preferencial deri në 10 kandidatë, mesatarja e kandidatëve të votuar është vetëm 5.3 sosh. Prandaj, KDI rekomandon që vota preferenciale duhet të kufizohet në tre kandidatë, duke kontribuar në një garë më konkurruese mes kandidatëve dhe duke siguruar të ruhet kuota gjinore prej 30 %", thuhet në komunikatën e KDI-së. Çështja e tretë problematike që është futur në projektligjin e ri për zgjedhjet, sipas KDI-së, është mundësia e shkarkimit të kryesuesit apo anëtarëve të KQZ-së me propozim të 2/3 të përbërjes së KQZ-së për rastet e shkeljeve të integritetit apo

statusit të KQZ-së, që deri më tani ka qenë në diskrecion të plotë të presidentit. "Ndryshimet e propozuara, përveçse nuk adresojnë problematikën e paqartësisë mbi rrethanat e shkarkimit, në fakt mundësojnë cenim edhe më të rëndë të pavarësisë dhe integritetit të KQZ-së. Ndryshimet, në fakt, mundësojnë politizimin e përfundimit të mandateve të kryesuesit apo anëtarëve të KQZ-së, duke minuar besimin e publikut në këtë institucion", thuhet më tutje në komunikatë. KDI vlerëson se KQZ-ja nuk duhet të ketë mundësi ta propozojë shkarkimin e anëtarëve apo kryesuesit lidhur me shkeljet e pretenduara të statusit apo integritetit të KQZ-së. "Kurse projektligji i ri duhet t'i parashohë qartazi rrethanat, veprimet apo mosveprimet të cilat mund të përbëjnë shkelje të integritetit apo statusit të KQZ-së - që mund të përdoren si bazë për përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarëve të KQZ-së. Përveç reagimit mbi këto tri probleme më akute që prekin integritetin e zgjedhjeve, KDI dhe Demokracia në Veprim gjatë ditëve në vijim do të paraqesin dhe elaborojnë elemente të tjera të sistemit zgjedhor të cilat, fatkeqësisht, nuk janë marrë fare në konsideratë nga komisioni ad-hoc për reformën zgjedhore", është theksuar në komunikatën e KDI-së.

Përfundon dëshminë dëshmitari i gjashtë i Speciales

HAGË, 23 MAJ - Dëshmitari i gjashtë, me kodin 4355, duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të Jakup Krasniqit, avokatit Aidan Ellis, ka thënë se në vitin 1998 ka tentuar të kontaktojë me Adem Demaçin dhe Jakup Krasniqin. Këtë ai e kishte bërë pasi që, sipas tij, i kishin thënë se të njëjtët janë kryesorët e UÇK-së, raporton "Betimi për Drejtësi".

Kur iu lexua një pjesë e deklaratës së tij në Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS-së), se "Prokurori të ka pyetur kush ishte në atë kohë Adem Demaçi, dhe ti je përgjigjur 'në atë kohë ata thonin që ishte kryesori, thonin është mbi UÇK-në', do të ishte përsëri përgjigja juaj kjo', ai tha se 'në atë kohë ashtu thoshin'.

Ai, po ashtu, tha se njerëzit i

kishin thënë se Adem Demaçi ishte përfaqësuesi politik i UÇK-së, andaj edhe kishte shkuar në Prishtinë. Më tutje, ai tha se kishte shkuar në fshatin e Jakup Krasniqit për ta takuar atë së bashku me nënën e tij, por nuk e kishin gjetur dhe se për çështjen e tyre s'kishin biseduar me të. Ai edhe për deklarinimin e tij para prokurorisë se Krasniqi ishte mbi ushtrinë, tha se e kishte thënë se kishte kuptuar se ai ishte zëdhënës i UÇK-së.

Dëshmitari i gjashtë në gjykimin e Thaçit dhe të tjerëve, duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtjes së Rexhep Selimit, avokatit Eric Tully, tha se fshatarët kanë bërë roje natën nga frika prej forcave serbe. "Bojshin roje, e runin fshatin nga forcat serbe, kishin frikë natën mos po hijjnë e me

dhon alarm që ka diçka", tha ai. I pyetur se a ka qenë e zakonshme që edhe fshatarat e tjera ta bëjnë këtë roje natën, përmbajtja ka qenë e redaktuar. Dëshmitari u përgjigj edhe në disa pyetje nga trupi gjykues, por që shumica e tyre kishin përmbajtje të redaktuar.

Dëshmitari i gjashtë është përgjigjur edhe në pyetjet e prokurorit të specializuar Matt Halling.

Ky i fundit ka kërkuar që të kalohet në sesion privat për disa pyetje.

Në seancën e së martës të pranishëm në sallë të gjykimin ishin Thaçi, Veseli dhe Selimi, kurse Krasniqi e ka përcjellë atë përmes videolidhjes.

Gjatë muajit prill ka filluar gjykimin derisa në seancën e 3

prillit, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe mbrojtësi i viktimave kanë paraqitur deklarinimet hyrëse dhe pas leximit të aktakuzës së ndryshuar nga ana e ZPS-së, ish-presidenti Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, si dhe ish-deputeti Rexhep Selimi, u deklaruan të pafajshëm për veprat penale që u vihen në barrë.

Më 4 prill mbrojtja e Thaçit, Veselit dhe Selimit kanë dhënë fjalën hyrëse derisa më 5 prill mbrojtja e Krasniqit ka dhënë fjalën hyrëse.

Më 11 prill ka filluar paraqitja e provave të Prokurorisë, ku dëshmitarja e parë e mbrojtur e Prokurorisë ka dhënë dëshminë e saj më 11 prill, 12 prill, 13 prill dhe

më 17 prill.

Më 17 prill ka filluar dëgjimi i dëshmitarit të dytë, po ashtu i mbrojtur, i cili ka vazhduar dhënien e dëshmisë edhe më 18 prill, 19 prill dhe 20 prill, ku ka përfunduar dhënien e dëshmisë edhe dëshmitari i tretë, kurse më 10 maj ka filluar dhënien e dëshmisë dëshmitari i katërt, dëshmia e të cilit përfundoi më 17 maj.

Më tutje, dëshmitari i pestë e ka filluar dëshminë më 17 maj dhe e ka përfunduar më 22 maj, ku filloi dëshminë dëshmitari i gjashtë. Në këto rrethana dëshmitari i gjashtë ka përfunduar dhënien e dëshmisë së tij dhe ka filluar dëshminë dëshmitari i shtatë në këtë çështje, i cili fillimisht ka vazhduar të përgjigjet në pyetjet e ZPS-së në sesion privat.



Çitaku për qeverinë Kurti: Pa asnjë ide konkrete se si të ndihmohet qytetari

PRISHTINË, 23 MAJ - Nënkrjetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka drejtuar akuza në drejtim të qeverisë Kurti. Ajo ka shkruar në "Facebook" se kjo klasë qeverisëse më së shumti definohet nga mungesa e ambicies dhe guximit për të marrë vendime. "Sillen si administratorë të dobët të taksave tona", është shprehur Çitaku. Sipas saj, kjo qeveri nuk ka asnjë ide korrekte se si të

ndihmohet qytetari. Gjithashtu, ka drejtuar kritika edhe për mungesë të investimeve kapitale. "Pa asnjë ide konkrete se si të ndihmohet qytetari i Kosovës, si të ndihmohet sektori privat, si të luftohen barrierat në mënyrë që secili të ketë më shumë mundësi për ta realizuar potencialin e vet. Pa investime kapitale. Pa vizion", ka thënë nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku.



500 euro gjobë kundërvajtësit dhe një vit marrje e patentëshoferit

FERIZAJ, 23 MAJ - Policia Rajonale e Komunikacionit Rrugor në Ferizaj, në rrugën "Driton Islami" në Ferizaj, ka ndaluar shoferin F. K. (M/K), i moshës 25 vjeçe, i cili me veturë ka bërë tejkalim të shpejtësisë. Ai në zonën e kufizimit 50 km/h, ka zhvilluar shpejtësi 127 km/h.

Ndaj tij policia shqiptoi një gjobë kundërvajtëse sipas Ligjit të Komunikacionit Rrugor me dënim 500 euro, 5 pikë negative dhe një vit masë mbrojtëse, heqje e patentëshoferit. Me këtë rast, Policia Rajonale në Ferizaj u bën thirrje shoferëve të

automjeteve që ta respektojnë shpejtësinë dhe shenjat e komunikacionit. "Veprimet e tilla rrezikojnë direkt jetën e tyre dhe pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion dhe fton qytetarët të bashkëpunojnë me policinë", ka njoftuar policia.

Hapet 'Biblioteka e Adem Demaçit'

PRISHTINË, 23 MAJ - Në kuadër të "Javës së Bibliotekës në Kosovë", dje në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani" është hapur "Biblioteka e Adem Demaçit". Në hapjen e kësaj biblioteke ka marrë pjesë edhe kryeministri i vendit, Albin Kurti, i cili ka bërë thirrje të lexohen librat e Demaçit. "Populli i Adem Demaçit, populli i bacës Adem, që i përdori

më së miri burgjet si bibliotekë, nuk ka se si të mos e përdorë mirë bibliotekën për një liri më të ditur. Nuk mjafton t'i lexojmë librat e bacës Adem e të mësojmë për të, por duhet të shkojmë edhe te 'Biblioteka e Adem Demaçit' dhe te Adem Demaçi si bibliotekë, t'i lexojmë librat e tij, por edhe t'i lexojmë librat që ai lexoi", ka thënë

Kurti. E pranishme ishte edhe zëvendësministrja e Kulturës, Daulina Osmani. "Përderisa kemi para një javë me përplot aktivitete në të gjitha bibliotekat e Kosovës, po ashtu tash kemi një hapësirë të veçantë për të qenë më afër mendësisë, ideve dhe veprimtarisë së Bacës Adem", ka theksuar

Osmani. Ndërsa Shqiptar Demaçi ka lexuar idenë për lëvizjen politike, të shkruar nga babai i tij. Ai ka bërë me dije se të njëjtën letër, me shkrimin original të Adem Demaçit, do ta deponojë në bibliotekë. "Ne synojmë që në sistemin tonë politik t'i përfshijmë të gjitha të arriturat pozitive të deritashme të njerzimit

në të gjitha fushat. 11 gusht, 2014, Prishtinë, Adem Demaçi. Kjo do të deponohet tani në bibliotekë do të mbesë aty, meqenëse është origjinali", ka thënë i biri i Adem Demaçit. Biblioteka Kombëtare e Kosovës ka hapur të hënën edicionin e 20 të Javës së Bibliotekës. Aktivitetet do të zgjasin deri më 28 maj.

Zgjedhen këshillat e ri të fshatrave në Kçiq të Madh dhe Kçiq të Vogël

MITROVICË, 23 MAJ - Në fshatrat Kçiq të Madh dhe Kçiq të Vogël janë mbajtur zgjedhjet për kryetar dhe anëtarë të këshillave të këtyre fshatrave. Në fshatin Kçiq të Madh kryetar i këshillit të fshatit është zgjedhur Fatmir Salihu dhe janë përzgjedhur edhe 11 anëtarë të këshillit. Në këtë takim kanë marrë pjesë 46 banorë të cilët kanë marrë pjesë edhe në procesin e votimit. Gjithashtu, zgjedhjet për

kryetarin dhe Këshillin e fshatit janë mbajtur në po të njëjtën ditë edhe në Kçiq të Vogël, ku kanë marrë pjesë 34 pjesëmarrës me të drejtë vote. Kryetar i këshillit të fshatit Kçiq i Vogël u zgjodh Shahin Fetahu, ndërsa këshilli i këtij fshati do të ketë shtatë anëtarë. I pranishëm në procesin e përzgjedhjes së kryetarëve dhe anëtarëve të këshillit ishte edhe nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, si dhe anëtarët e

komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, Armend Begu, Xhyljeta Morina Imeri, Majlinda Kurti, Jeton Ujkani dhe Valbona Sadiku. Në fjalën e tij, nënkryetari Tahiri ka thënë se është për t'u vlerësuar pjesëmarrja dhe fryma demokratike e promovuar, ndërsa kryetarëve Fatmir Salihu dhe Shahin Fetahu u uroi suksese, duke premtuar bashkëpunim të ngushtë në të mirën e fshatrave dhe lagjeve.

Kryetari i Skenderajt viziton bujqit që kanë përfituar nga subvencionet e komunës

SKENDERAJ, 23 MAJ - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe drejtori për Bujqësi, Pyltari dhe Zhvillim Rural, Behxhet Maliqi, kanë vizituar bujqit Muhadin Temaj dhe Aulona Suhogërrlla të cilët kanë përfituar nga subvencionet publike të komunës e të cilët merren me kultivimin e

perimeve si speci, domatja dhe trangulli. "Aulona Suhogërrlla dhe Muhadin Temaj, dy bujq në mesin e 62 të tjerëve që kanë përfituar nga pakoja e mbështetjes prej 167 mijë fijesh të rasatit, nëpërmjet subvencioneve për kultivimin e specit, domates dhe trangullit, duke u marrë me rritjen e

perimeve dhe shitjen e tyre në tregun vendor, sigurojnë një ekonomi të qëndrueshme familjare me të ardhura të kënaqshme", ka thënë kryetari Nura. Komuna e Skenderajt i ka dhënë prioritet sektorit të bujqësisë, si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë së vendit.



Migrimi mbetet sfidë për shtetin e Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 MAJ - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme është mbajtur të martën konferencë për lansimin e projektit "Zgjerimi i qeverisjes së migrimit nëpërmjet programeve të bazuara në evidenca dhe forcimi i kapaciteteve të autoriteteve të migrimit në Kosovë".

Në këtë takim mori pjesë ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly, shefja e IOM-it në Kosovë, Anna Rostocka, përfaqësues të Policisë së Kosovës si dhe organizata partnere në Kosovë.

Në hapje të konferencës, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, fillimisht falënderoi shtetin dhe popullin zviceran për përkrahjen e vazhdueshme që ka ofruar për vendin dhe institucionet e Kosovës ndër vite. Ai tha se Zvicra ka qenë dhe mbetet ndër partnerët tanë

kryesor drejt zhvillimit të shtetit tonë dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës së qytetarëve të Republikës së Kosovës. "Migrimi mbetet një sfidë për shtetin e Kosovës, rajonin dhe më gjerë. Zhvillimet e ndryshme, sidomos luftërat dhe konfliktet, detyrojnë largimin dhe migrimin nga vendet e ndryshme të botës, të cilët lëvizin përmes rajonit të Ballkanit Perëndimor. Andaj, prioriteti ynë ka qenë dhe mbetet parandalimi i migrimit të parregullt, duke luftuar grupet kriminale që merren me kontrabandim me migrantë, si dhe duke zgjeruar infrastrukturën dhe përmirësuar shërbimet për pritjen, akomodimin dhe trajtimin e dinjitetshëm të migrantëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare", ka theksuar ministri Sveçla.

Ministri Sveçla vuri në dukje se projekti që po lansohet sot është i rëndësishëm për përmbushjen e objektivave tona në fushën e



migrimit.

Zgjerimi i kapaciteteve dhe infrastrukturës për pritjen dhe trajtimin e migrantëve që është pjesë e këtij projekti, reflekton prioritetet dhe politikat tona shtetërore për: menaxhim të lëvizjeve migratore si dhe trajtimin e migrantëve sipas

standardeve ndërkombëtare dhe parimeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut etj. Objektiv i përgjithshëm i këtij projekti është të kontribuojë në përmirësimin e qeverisjes së migrimit, duke u bazuar në evidenca gjithëpërfshirëse dhe ta

maksimizojë potencialin e migrimit për të arritur rezultate konkrete të zhvillimit të qëndrueshëm.

Vlera e projekti është 2.1 milionë franga zvicerane dhe është financuar nga Konfederata Zvicerane, kurse do të realizohet nga organizata për migrim IOM.

Nënkryetarja serbe e Mitrovicës së Veriut: Përmbytjet nuk pyesin se kush je

MITROVICË, 23 MAJ - Katarina Agjançiq, edhe pse ka dalë kundër shumicës së bashkëvendësve të saj serbë në veri të Kosovës, të cilët i kanë bojkotuar zgjedhjet e jashtëzakonshme të prillit, thotë se nuk ka frikë e as sigurim.

Agjançiq, ish-punonjëse e Administratës Tatimore të Kosovës, më 19 maj ka pranuar pozitën e nënkryetares së Mitrovicës së Veriut. Në një intervistë dhënë "Radios Evropa e Lirë", ajo i përshkruan "normale" marrëdhëniet e saj me partinë kryesore të serbëve, Lista Serbe.

Vendimin për të dalë kundër mosgatishmërisë së saj për t'i dhënë fund bojkotimit të institucioneve të Kosovës tash e gjashtë muaj, Agjançiq thotë se e ka marrë për faktin se nuk ka mundur të qëndrojë duarkryq kundrejt pasojave që ka shkaktuar mosfunksionimi i institucioneve në katër komunat



në veri të Kosovës. "Popullata lokale do rezultate, njerëzit duan rezultate. Unë nuk kam pyetur nëse do të më pranojnë ose jo, por e kam marrë përgjegjësinë mbi vete dhe dua të arrij rezultate. Le të thonë kështu apo ashtu, e mirë apo e keqe. Ka kohë

që i kam lënë prapa këto. Kështu më ka mësuar zyra e tatimeve. Taksambledhësit nuk i do askush", ka thënë ajo.

E pyetur se si do të dukej vetëqeverisja lokale, Agjançiq ka thënë se në komunën Mitrovicës së Veriut punojnë njerëz që kanë

punuar edhe më herët. "Në komunë punojnë njerëz që kanë punuar edhe më herët nga komuniteti shqiptar. Qytetarët kanë vazhduar të vijnë për të nxjerrë dokumente. Tani prioriteti ynë është t'i krijojmë drejtoritë sa më shpejt që të jetë e

mundur, ta formojmë një shërbim ekzekutiv dhe të fillojmë me kapacitet të plotë", është shprehur nënkryetarja serbe e Mitrovicës së Veriut, Katarina Agjançiq.

Në pyetjen se sa do të zgjasë kjo qeverisje, Agjançiq është përgjigjur: "Nuk e kam menduar, nuk dua ta ngarkoj veten me këtë. Nuk varet nga unë apo nga ju. Është e rëndësishme për mua t'i arrij disa rezultate. Dyert tona janë të hapura për të gjithë, përfshirë opsionet politike, qytetarët - këdo që ka qëllime të mira".

Duke folur për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Agjançiq ka thënë se kjo është ajo politika e lartë, ku Beogradi dhe Prishtina duhet ta frenojnë dhe ta ndryshojnë mënyrën e retorikës. "Pastaj, tensionet do të ulen dhe do të qetësohen, por përsëri kush jam unë që t'i këshilloj politikanët e lartë? Por, populli mendon kështu" është shprehur Agjançiq.

Ndalohej për 48 orë drejtori i "VisaMetric"

PRISHTINË, 23 MAJ - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka njoftuar se në kuadër të ndërmarrjes së veprimeve hetimore lidhur me rastin "VisaMetric", prokurorja e shtetit, sot, pas marrjes së deklaratës nga i pandehuri S. O., (shtetas turk), drejtor i këtij subjekti, me aktvendimin mbi ndalim, e ka ndaluar të njëjtin në kohëzgjatje prej 48 orësh për shkak të veprës penale "Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore", nga neni 394, paragrafi 2, lidhur me

paragrafin 1 të KPRK-së. Kështu është bërë me dije në njoftimin për medie të Prokurorisë Themelore në Prishtinë. "Gjithashtu, ju njoftojmë se brenda afatit ligjor prokurorja e çështjes ndaj të njëjtit do t'i ndërmarë veprimet e mëtejme ligjore, derisa ju bëjmë me dije se lidhur me këtë rast janë duke u zhvilluar hetimet deri në epilogun përfundimtar të kësaj çështjeje penale", thuhet në njoftimin për medie.

Kompania "VisaMetric" ka

pranuar ditë më parë vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, me të cilin i ndalohej t'ua marrë nga 30 euro për shërbime postare qytetarëve që aplikojnë për viza gjermane.

Avokati Flamur Abdullahu, i cili kishte paditur këtë kompani në Gjykatën Komerciale, ditë më parë kishte thënë për "Telegrafin" se vlera prej 30 eurosh për person përbën disa miliona përfitime për kompaninë në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit.



Sindikalistët në Maqedoni, në betejë me qeverinë për ruajtjen e 40 orëve punë në javë

SHKUP, 23 MAJ - Sindikata e Ndërtimtarisë ka paralajmëruar se do t'i kontestojë në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut ndryshimet në projektligjin për ndërtim i cili ka shkuar për miratim në Kuvend. Këto ndryshime parashikojnë zgjatjen e orarit të punës në këtë sektor në më shumë se 40 orë punë në javë aq sa parashikohet tani në Ligjin e Punës. Kjo thuhet se ka bërë me ndërtimin e autostradave të korridorit 8 dhe 10-D nga konsorciumi amerikan-turk "Bechtel & Enka".

Kjo kompani ka fituar të drejtën e ndërtimit të dy autostradave me një gjatësi prej 110 kilometrash, me një kosto prej 1.3 miliard eurosh, me një ligj të posaçëm të miratuar në kuvendin maqedonas më 15 korrik 2021. Por, bazuar në Ligjin e miratuar dhe marrëveshjen e arritur me kompaninë ndërtuese, janë paraparë edhe zgjidhje të tjera ligjore që po miratohen në Kuvend me procedurë të përspejtuar, përfshirë Ligjin për Ndërtim dhe katër ligje të tjera që kanë të bëjnë me rrjedhën e punimeve, shpronësimin, heqjen e doganave për materialet e ndërtimit si dhe fuqinë punëtore.

Ligji për Marrëdhënie Pune në Maqedoninë e Veriut thotë se "java ka pesë ditë pune, nga e hëna në të premten dhe përfshin jo më shumë se 40 orë punë, apo nga 8 orë në ditë". Dispozitat ligjore parashikojnë edhe kohë shtesë në rrethana të veçanta apo angazhimit e punëtorëve edhe në ditët e fundjavës në ato veprimtari ku procesi i punës nuk mund të

ndërpritet, por koha shtesë në punë ose kompensohet me pushim në ditët e tjera ose paguhet.

Megjithatë, Sindikata e Ndërtimtarisë thotë se këto dispozita nuk duhet të interpretohen edhe si mundësi që orari të zgjatet edhe në këtë sektor, andaj edhe paralajmëron kontestimin e ndryshimeve në Gjykatën Kushtetuese. "Me këtë projektligj java në ndërtimtarin nuk do t'i ketë 60 orë punë, por 72 orë. Nëse ky propozim kalon, atëherë pas 137 vjetëve do të humbim një të drejtë që e kishim fituar me gjak, që njerëzit të punojnë tetë orë në ditë, tetë orë të tjera t'i shfrytëzojnë për pushim dhe tetë orë për gjumë, për të qenë produktivë të nesërmen në punë. Qeveria jonë mendon se duhet t'i kthejë punëtorët maqedonas të ndërtimit në skllevër që të punojnë nga 40-60 si orë të rregullta - plus 12 orë të tjera jashtë orarit", thotë për "Radion Evropa e Lirë" Ivan Peshevski, kryetar i kësaj sindikate.

Ndryshimet synohet të miratohen përkundër vendimit të vitit 2020 të Gjykatës Kushtetuese, e cila kishte hedhur poshtë një dispozitë ligjore që u mundësonte kompanive t'i angazhohen punëtorët e tyre deri në 60 orë në javë. "Ne do të jemi të detyruar t'i kundërshtojmë këto ndryshime para Gjykatës Kushtetuese, e cila besojmë se do të vendosë përsëri për të njëjtat konkluzione, të njëjtat dispozita, të njëjtat vendime, sepse është e pamundur që në një sektor me rrezikshmëri të lartë, si ndërtimtaria, ku njerëzit janë të ekspozuar ndaj ndikimeve të jashtme gjatë



gjithë javës, të punojnë jashtë orarit të punës". "Është e pamundur të punosh më shumë se 50 orë në javë në sektorin e ndërtimit, sepse ne kemi parë në të kaluarën punëtorë të lënduar, punëtorë që bien nga skelat, të vdekur në autostrada. Ky është një sektor me rrezik të lartë, ku njerëzit janë të rraskapitur gjatë tetë orëve punë e të mos flasim të punojnë edhe më gjatë", thotë Peshevski.

Ndryshimet janë kundërshtuar edhe nga partitë opozitare të cilat thonë se "do të bëjnë çmos që ato të mos miratohen".

VMRO DPMNE dhe partitë e tjera të opozitës kanë dorëzuar qindra amendamente për ta penguar miratimin jo vetëm të ndryshimeve në projektligjin për ndërtimtarin, por edhe gjithë marrëveshjen meqë, siç thonë,

marrëveshja me kompaninë "Bechtel & Enka" është "skandali më i madh korruptiv në vend" për shkak të arritjes së saj pa procedurë të hapura tenderuese.

Por, qeveria thotë se autostradat do të ndërtohen me ose pa pëlqimin e opozitës, ndërsa hedh poshtë pretendimet e sindikatave dhe të Lidhjes së Odave Ekonomike për shkelje të procedurave ligjore dhe të drejtave të punëtorëve. "Edhe tani te ne kemi zgjidhje ligjore që ua mundësojnë kompanive apo punëtorëve të angazhohen në punë më shumë se 40 orë në javë, apo 50 orë. Kështu që kemi punëtorë që me dëshirën e tyre pranojnë të punojnë më shumë sesa që është e paraparë në Ligjin për Marrëdhënie Pune. Me ose pa këto ndryshime ligjore, korridoret do të

ndërtohen. Ne besojmë se nëse miratohen ndryshimet për 60 orë punë në javë, do të rritet produktiviteti në punë dhe do të punësohen më pak punëtorë nga jashtë", tha kryeministri maqedonas Dimitar Kovačevski. Ai tha se asnjë punëtor nuk do të detyrohet të punojë me forcë më shumë se 40 orë, por kjo nuk duhet t'u pamundësohet atyre që duan, dhe për çdo orë shtesë që do të bëjnë do të paguhet edhe më shumë sesa koha e rregullt e punës.

Për shkak të bllokimit të opozitës, qeveria ka vendosur që ligjet të miratohen me procedurë të shkurtër apo me "flamurin evropian", edhe pse kjo procedurë është kritikuar edhe nga zyrtarë të BE-së - pasi nuk ka të bëjë me harmonizim të ligjeve që të mund të aplikohen në rastin konkret.

ATK-ja kërkon nga sektori i gastronomisë dhe këngëtarët t'i deklarojnë detyrimet tatimore

PRISHTINË, 23 MAJ - Duke pasur parasysh që tashme kemi hyrë në sezonin kur disa sektorë të bizneseve rritin aktivitetin e tyre, Administrata Tatimore e Kosovës u ka bërë thirrje të gjithë tatimpaguesve të cilët në aktivitetet e tyre kanë veprimtarinë e gastronomisë/hotelerisë, këngëtarëve, stilistëve, si dhe salloneve të bukurisë, që t'i deklarojnë saktë detyrimet e tyre tatimore, në të kundërtën do të veprojnë sipas thirrjeve ligjore. "ATK-ja paralajmëron se para se t'i fillojë verifikimet dhe kontrollet tatimore, u bën thirrje të gjithë personave e bizneseve t'i deklarojnë dhe paguajnë saktë obligimet e tyre të përcaktuara me



legjislacionin tatimor në fuqi, në të kundërtën ne jemi të obliguar të fillojmë verifikimet dhe hapjen e kontrolleve tatimore, të cilat mund të rezultojnë me ndëshkimet nga

parregullsitë dhe pasaktësitë e hasura", thuhet në njoftimin e ATK-së.

Sipas ATK-së, gjatë sezonit të verës shumëfishohen aktivitetet e lartpërmendura, të

cilat, bazuar në aktivitetin që kanë, janë si një zinxhir, ku kryesisht janë shumë evidente ndeja të ndryshme, si në restorante ashtu edhe në diskoteka, në të cilat ndërlidhen pjesa e këndimit ose DJ, si dhe përgatitja nga sallonet e bukurisë dhe stilistët. "Për këtë qëllim ATK ka dizajnuar projektin për Akomodim dhe Shërbime Ushqimore, i cili, bazuar në të dhënat e përbushjes, renditet si një ndër industritë me nivel të lartë të mospërbushjes së detyrimeve tatimore, andaj edhe është pjesë e planeve specifike të përbushjes për grupet e identifikuar me rreziqe të larta për vitin 2022", thuhet në njoftim.

Modulet e ndërtuara përbrenda ATK-së kanë nxjerrë faktorë të ndryshëm që kanë kontribuar në përzgjedhjen e kësaj industrie si: pagesa/të hyra përgjithësisht të ulëta pavarësisht numrit të madh të tyre; mosdeklarim i punëtorëve dhe pagesa cash e tyre; mosdeklarimi apo nëndeclarimi i ahengjeve dhe mosmbajtja e evidencave lidhur me këngëtarët gjatë mbrëmjeve muzikore; moslëshimi i kuponëve fiskalë; pagesat po ashtu në cash të realizuara në mes të konsumatorëve dhe bizneseve gjatë organizimit të ahengjeve të ndryshme; si dhe mosmbajtja e tatimit në qira apo nëndeclarimi i saj.

Nirvana: Gjendja e çlirimit total

Nirvana është një nga konceptet më të rëndësishme në Budizëm, Jainizëm dhe Hinduizëm, një gjendje që mund të arrihet vetëm përmes praktikave ose teknikave shpirtërore.

Nirvana konsiderohet një gjendje çlirimi nga vuajtjet ose dukka, e lidhur me ciklin e lindjes dhe vdekjes së filozofisë sramana. Është një nga konceptet më të rëndësishme në Budizëm, Jainizëm dhe Hinduizëm, një gjendje që mund të arrihet vetëm nëpërmjet praktikave ose teknikave spirituale.

Kushdo që arrin në gjendjen e Nirvanës çlirohet nga çdo vuajtje, por kjo kërkon një përpjekje të mundimshme, një udhëtim të gjatë shpirtëror që synon çlirimin nga të gjitha lidhjet tokësore.

Pse është i rëndësishëm gjendja e Nirvanës në Budizëm?

Nirvana është një gjendje shumë e rëndësishme në budizëm pasi thyen ciklin e samsaras, i cili përjetëson gjendjen tonë të vuajtjes përmes rimishërimit dhe efekteve të karmës.

Gjendja e Nirvanës është e barabartë me çlirimin absolut, pasi dikush del nga cikli i lindjes dhe vdekjes. Borxhet karmike shlyhen përgjithmonë dhe njeriu mbetet i pastruar nga çdo lloj dhimbjeje. Është çlirimi përfundimtar i

lakmuar drejt të cilit përpiqen ata që praktikojnë Budizmin, Jainizmin ose Hinduizmin. Mund të thuhet se Nirvana është një portë për paqen e plotë, që nuk i nënshtrohet më faktorëve të jashtëm.

Në një kuptim më të gjerë, kjo fjalë ndonjëherë përdoret për të përcaktuar dikë që ka arritur të kapërcejë veten ose ka dalë nga një situatë veçanërisht e ndërlikuar. Çdo rrethanë apo emocion negativ që gjeneron siklet të brendshëm është një pengesë për lumturinë. Nëpërmjet Nirvanës, ne e çlirojmë shpirtin tonë nga kjo robëri dhe gjejmë plotësinë e ekzistencës.

Si arrihet çlirimi?

Rruga drejt Nirvanës është një udhëtim individual për të zbuluar të vërtetën absolute, nuk është një destinacion për të arritur. Për të arritur një gjendje të çlirimit të plotë, duhet të heqësh dorë nga të gjitha llojet e lidhjeve dhe dëshirave materiale. Në fakt, lidhja gjeneron vuajtje.

Një qenie është e lirë kur kapërcen atë që e mban të lidhur, siç ndodh me ndjenjat negative. Më pas njeriu përjeton një moment lumturie; nuk do të jetë më e nevojshme që cikli i jetës dhe vdekjes të vazhdojë, sepse të gjitha borxhet e karmës janë shlyer.

Megjithatë, nuk mund të përkufizohet Nirvana. Të bësh këtë



do të thotë ta përshtatësh atë me situatën tonë botërore ose kulturore. Arritja e saj kërkon një udhëtim meditues që na bën të hyjmë thellë në trupin dhe mendjen e ndërlidhur ngushtë.

Nirvana sipas psikologjisë

Nga pikëpamja e psikologjisë, Nirvana korrespondon me një

gjendje qetësie, të pajtimit me veten, të braktisjes së konflikteve. Një gjendje në të cilën mungesa e tensionit psikik nuk çon në një ulje të reflekteve shqisore, por më tepër në stabilitet emocional.


Nuk është në të vërtetë një koncept psikologjik sepse i përket një dimensionit tjetër, besimit dhe jo shkencës. Megjithatë, një pikënisje e mirë për reflektim mbetet, përkufizimi i një gjendje që të

aspirojmë, të rimbushim veten me energji dhe të ndërtojmë një ndryshim.

Në të njëjtën kohë, ideja na fton të marrim parasysh rolin motivues ose zhgënjyes të dëshirave, në varësi të gjendjes sonë emocionale. Një dëshirë mund të jetë një gur që na tërheq poshtë nëse e shikojmë me pesimizëm ose një ngarkesë energjie nëse kalërojmë krahët e optimizmit. / bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kompletohet shtabi teknik i Përfaqësueses së Kosovës

PRISHTINË, 23 MAJ - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) ka marrë vendim që, krahas trajnerit Rami Hadar, t'i emërojë anëtarët e shtabit profesional të Përfaqësueses A të Kosovës. Ndhimëstrajner të Përfaqësueses A të Kosovës

janë emëruar Bujar Loci, Ilir Selmani, Dritëro Sefaja. Andin Rashica është emëruar ndihmëstrajner/skautim, ndërsa Mehmet Ugur trajner kondicional. "Për shkak të analizave të lojës, lojtarëve, përgatitjes së stërvitjeve individuale dhe grupore,

përcjelljes së lojtarëve të rinj në Përfaqësueset e Reja të Kosovës, përzgjedhësi i ri i Përfaqësueses A, Rami Hadar, ka propozuar dhe Bordi i FBK-së ka miratuar anëtarët e Shtabit Profesional të profileve të lartpërmendura", thuhet në njoftimin e FBK-së.



Ademi dhe Rama pajtohen për stadiumin e ri në kryeqytet

PRISHTINË, 23 MAJ - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka pritur në takim kryetarin e komunës së Prishtinës, Përparim Rama. Në këtë takim ata kanë diskutuar rreth projektit për ndërtimin e stadiumit të ri në kryeqytet. Ky takim kishte për qëllim koordinimin ndërinstitucional për ndërtimin e këtij stadiumi të rëndësishëm për futbollin e Kosovës dhe komunitetin e Prishtinës në përgjithësi. Kreu i FFK-së dhe i pari i kryeqytetit u pajtuan për të bashkëpunuar për realizimin e këtij projekti të rëndësishëm për sportin kryeqytetas dhe jo vetëm. "Stadiumi i ri, i cili do të ndërtohet në Bërnice, do të jetë i kategorisë së katërt dhe do t'i plotësojë të gjitha standardet dhe kushtet e nevojshme për organizimin e

ndeshjeve ndërkombëtare, përkatësisht të ndeshjeve të ekipit kombëtar dhe klubeve në garat evropiane. Ky stadium do të jetë një vend i përshtatshëm për organizimin e aktiviteteve të tjera sportive dhe eventeve të ndryshme", thuhet në njoftimin e FFK-së. Ademi dhe Rama kanë rënë dakord që Federata e Futbollit e Kosovës ta ketë përgjegjësinë për menaxhimin e stadiumit të ri, në të njëjtën mënyrë siç ndodh me stadiumin "Fadil Vokrri". Ata diskutuan edhe për mirëmbajtjen e stadiumit ekzistues, gjendjen e fushës dhe organizimin e ndeshjeve kombëtare dhe të ekipeve që garojnë në Evropë. Kryetari Rama ka shfaqur interesimin e tij për zhvillimin e sportit, veçanërisht futbollit në kryeqytet, duke e parë atë si sportin më të popullarizuar



në Kosovë. Të dy krerët e institucioneve janë zotuar të krijojnë kushte sa më të mira për sportin në kryeqytet dhe të përkushtohen bashkërisht për organizimin sa më të mirë të klubeve të kryeqytetit. Kryetari i FFK-së, Agim

Ademi, i ka dhuruar kryetarit Rama fanellën e Përfaqësueses së Kosovës dhe e ka falënderuar për gatishmërinë e tij për të kontribuar në zhvillimin e futbollit të Kosovës. Ata kanë shprehur vullnetin për të

nënshkruar Memorandum të Bashkëpunimit në përputhje me praktikën e krijuar me komunat e tjera të Kosovës. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e futbollit të Kosovës dhe në ngritjen e nivelit të klubeve në kryeqytet.

Tërhiqet shorti për finalen e Kupës së Kosovës, FC Prishtina luan në cilësinë e mysafires



PRISHTINË, 23 MAJ - Në zyrat e Federatës së Futbollit të Kosovës është tërhequr shorti për finalen e Kupës së Kosovës për edicionin 2022/23. Në ndeshjen që do të zhvillohet më 5 qershor në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë me fillim nga ora 18:00, FC Prishtina do të

jetë skuadër mysafire. FC Prishtina në këtë ndeshje do të luajë me fanella të bardha, kurse SC Gjilani me të kuqe. Gjithashtu, është vendosur edhe se ku do të vendosen tifozët e të dyja skuadrave. "Plisat" e Prishtinës do të vendosen në pjesën jugore të stadiumit,

teksa "Skifterat" e SC Gjilanit në veri. Për tifozët e organizuar nga të dyja klubet, FFK ka vendosur t'i japë nga 200 bileta falas. Janë caktuar edhe çmimet e biletave. Biletat në pjesën perëndimore kushtojnë 10 euro, 5 euro në lindje dhe 3 euro në veri dhe jug.

Adis Beqiragiq emërohet trajner i KB Trepça

MITROVICË, 23 MAJ - Finalistja e Superligës së Kosovës në basketboll, KB Trepça, e ka zyrtarizuar të martën trajnerin e ri, boshnjakun Adis Beqiragiq. "Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë që Adis Beqiragiq është trajner i ri i skuadrës sonë. Beqiragiq

është trajner i dëshmuar në basketbollin tonë dhe shumë i suksesshëm", thuhet në njoftimin e Trepçës. Beqiragiq më parë ishte pjesë e Golden Eagle Yllit, ndërsa është përzgjedhës edhe i Kombëtares së Bosnjë-Hercegovinës. Trajneri

boshnjak do ta zëvendësojë Ilir Selmanin që e udhëhoqi Trepçën në dy finalen e fundit të "play-off"-it të Superligës së Kosovës. Trepça humbi në finale kundër Pejës duke mos arritur ta sjellë trofeun e shumëkërkuar në Mitrovicë edhe pas një dekade.



Prishtina do të bëhet me 15 fusha të reja

PRISHTINË, 23 MAJ - Drejtori për Sport në komunën e Prishtinës, Granit Rugova, ka njoftuar se kryeqyteti do të pasurohet me disa fusha të cilat do të rinovohen dhe do të transformohen në

pjesë të ndryshme. Rugova i ka inspektuar fushat në lagje, të cilat konsideron se janë në gjendje të mjerueshme, ndërsa ai po e nis projektin e radhës për rregullimin e tyre. "Sot jam në Kolovicë për ta

evidentuar gjendjen e mjerueshme të fushës së jashtme sportive. Fatkeqësisht, në gjendje të tillë janë edhe shumë fusha të tjera në komunën e Prishtinës. Prandaj, sot, zyrtarisht, po nis

projektin e radhës për rinovimin dhe transformimin e 15 fushave të para në mbarë kryeqytetin. Projekti do të vazhdojë edhe në fazën e dytë - ku asnjë fushë nuk do ta lëmë pa rregulluar.



Astera: Ndjenjë e jashtëzakonshme ta përfaqësosh Kosovën

PRISHTINË, 23 MAJ - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu, sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku dhe menaxheri i përfaqësuesve, Adriatik Rraci, kanë pritur në takim basketbollistën e talentuar Astera Tuhina. Dushku ka thënë se janë të lumtur për sukseset e Asterës, si dhe së bashku me kryetarin Fetahu i kanë dëshiruar suksese në Evropianin U20, ku do të marrin pjesë "Dardanet" e reja. Tuhina ka folur për sukseset individuale dhe me skuadrën Washington State Cougars. "Edhe pjesa individuale edhe me skuadër, kam pasur suksese të jashtëzakonshme. Ky edicion ka qenë i jashtëzakonshëm. Me skuadër kemi fituar konferencën e PAC-12. Ka qenë diçka që nuk ka ndodhur më herët në kolegjin tonë". Astera ka folur edhe për përfaqësimin që e bën për Kosovën. "Është ndjenjë e jashtëzakonshme me përfaqësu



Kosovën. Unë kam qenë pjesë e Përfaqësueses A me vetëm 16 vjet, ndërsa vitin e kaluar kam qenë në top 5 të Kampionatit". Basketbollistja e talentuar ka folur edhe për synimet këtë vit, ku do të jetë pjesë e

Përfaqësueses me grupmoshat U20, kampionat i cili do të mbahet në Rumani. Për Kosovën U20, Tuhina u shpreh se do ta japë maksimumin për të pasur sa më shumë suksese në garat ndërkombëtare.

Denveri mposhti lakersat, kualifikohet për herë të parë në finalet e madhe

DENVER, 23 MAJ - Skuadra e Denver Nuggetsit u shpall kampione në Konferencën e Perëndimit në NBA pas fitores në frymën e fundit me rezultat 113-111 ndaj lakersave, në ndeshjen e katërt finale. Denveri fitoi kështu 4-0 serinë e ndeshjeve, duke fituar titullin e parë në histori në Konferencën e Perëndimit në NBA. Për pasojë, Denveri do të luajë për herë të parë në 47 vjet histori për titullin kampion në NBA, me fituesin që do të dalë nga sfida në mes të Miamit e Bostonit (3-0 për Miamin). Edhe një herë ai që bëri dallimin në fushë ishte Nikola Jokiq, autor i një "triple double", me 30 pikë, 14 rebounde e 13 asistime. Ndeshja ishte e hapur deri në fund, më e mirë për lakersat në pjesën e parë, ku shkëlqeu LeBron Jamesi, autor i 40 pikëve e 10 reboundeve. Davisi e mbylli me 21 pikë e 14 rebounde, por që s'mjaftuan për të fituar. Përveç



Jokiqit, për Denverin u dalluan edhe Murray me 25 pikë e Gordoni me 22 pikë. Jokiqi u shpall edhe MVP i këtyre finaleve, duke vendosur edhe rekordin e 8 "triple double" në finalet "play-off". Rekordi ishte me 7 "triple

double", vendosur në vitin 1967 nga Wilt Chamberlain. Tashmë Denveri do ta synojë titullin e parë në histori, ndërsa për Lakersat ky ishte maksimumi për një sezon që nisi keq, por që u përmirësua me kalimin e kohës.

SHKURT

Tare: Të ardhmen e diskutoj me presidentin Lotitto

Me kontratën që i skadon në fundin e sezonit aktual, e ardhmja e Igli Tares te Lazio është vendosur më shumë se kurrë në diskutim. Drejtori shqiptar ka bërë histori me bardhekaltrit me disa nga transferimet më të bujshme që mbajnë firmën e tij ndërsa në gjithë këto vite karrierë nuk kanë munguar edhe çmimet vlerësuese. Ofertat nuk i mungojnë dhe duket se Tare po merr të gjithë kohën e nevojshme për t'i vlerësuar ato tekta në një deklaratë të fundit thekson se së bashku me presidentin Claudio Lotitto do të marrin një vendim në favor të Lazios, klub me të cilin është i lidhur që prej kohës kur ishte futbollist. "Me Lazion nuk kam thjesht një marrëdhënie pune, kam një lidhje 18-vjeçare. E dua shumë klubin dhe kjo lidhje nuk do të shkëputet kurrë pavarësisht të ardhmes. Kontrata më përfundon pas një muaji dhe së bashku me presidentin do të flasim e do të vlerësojmë të ardhmen. Do ta marrim vendimin më të mirë të mundshëm", ka thënë Tare.

PSG-ja dhe Unitedi, në bisedime me Neymarin

Titulli i parë te "L'Equipe" informon në lidhje me të ardhmen e Neymarit. Sipas asaj që shkruan gazeta e njohur franceze, fokusi i PSG-së është të gjejë një ekip të ri për brazilianin Neymar. As klubi dhe as tifozët nuk e mbështetin më, prandaj edhe Manchester Unitedi është futur në këtë çështje, aq sa negociatat me Paris Saint-Germain dhe "Djajve të Kuq" tashmë kanë filluar.

Lewandowski, Kimmichit: Ia vlen të vish në Barcelonë

Sulmuesi polak Robert Lewandowski dëshiron që ish-bashkëlojtari i Bayern Munchenit, Joshua Kimmich, t'i bashkohet në Barcelonë. Lewandowski iu bashkua Barçës në fillim të sezonit 2022/23. Kimmich është shfaqur si një opsion i mundshëm për Barcelonën, pasi Xavi planifikon për periudhën pas Sergio Busquets sezonin e ardhshëm, me trajnerin spanjoll që tregon se një shtyllë e re në mesfushë është transferimi i tij. "Çfarë do t'i thosha Kimmichit për Barçën? Se ia vlen të vish këtu! Atmosfera është shumë e ndryshme nga Bayerni. Ato janë dy klube të mëdha, por përvoja dhe sfida janë të ndryshme", ka deklaruar Lewandowski.

Arsenali synon transferimin e Gundoganit

Arsenali po përgatitet të hyjë në garë për transferimin e kapitenit të Manchester Cityt, Ilkay Gundogan. Mesfushorit gjerman i skadon në fund të qershorit kontrata me tre herë kampionët në fuqi të Ligës Premierë. Ai ka të ngjarë të largohet në verë si lojtar i lirë, me Barcelonën që përflitet se i ka ofruar një kontratë dyvjeçare. Megjithatë, sipas mediumit "Evening Standard", trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, dëshiron të ribashkohet me Gundogan. "Gunnars" është i interesuar t'i shtojë ekipit ish-kontingjent të Cityt, pasi tashmë në sezonin e fundit morën dy lojtarë nga "Etihad". Arsenali tashmë ka Gabriel Jesus dhe Oleksandr Zinchenko, të cilët mbërritën verën e kaluar dhe patën sukses në "Emirates".

Mourinho pas dënimit të Joves: Kampionat i falsifikuar

AS Roma nuk shkoi më shumë se barazimi 2-2 ndaj Salernitanës në "Olimpico", sfida ku Jose Mourinho bëri disa ndryshime në formacion. "Special One" u ndal pas ndeshjes te dënimi i Juventusit

me -10 pikë nga Gjykata e Apelit pranë Federatës Italiane të Futbollit. Ndërkohë që Prokuroria Federale kishte kërkuar heqjen e 11 pikëve. "Është tallje për mua të marrësh vesh këtë dënim dy

javë përpara fundit të kampionatit. Për të gjithë ne, madje edhe për Juventusin. Nëse do të më kishin lajmëruar për këtë dënim përpara ndeshjeve ndaj Monzës dhe Bolognas, qasja ime dhe e

Romës do të ishte ndryshe. Ne vendosëm të fokusoheshim totalisht tek Liga e Evropës. Më vjen keq për Allegrin dhe lojtarët e Joves. Kampionat i falsifikuar? Unë mendoj se po, por nuk më pëlqen të flas më

për këtë temë. Preferoj të them se më vjen keq për profesionistët që punojnë si unë dhe që paguajnë sepse ndoshta drejtuesit dhe klubet kanë gabuar", ka deklaruar Mourinho.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Reing” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810235201 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Reing” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810235201 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Reing” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810235201 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Reing BN” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811362136 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Reing BN” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811362136 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Reing BN” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811362136 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Programi i praktikës për studentë****Qëllimi dhe kohëzgjatja:**

Programi i praktikës për studentë i ofruar nga BQK-ja mundëson lidhjen midis njohurive teorike të fituara gjatë studimeve dhe punës praktike në institucionet publike të pavarura. Ky program zgjatë katër javë dhe nuk nënkupton në asnjë mënyrë ndonjë marrëdhënie formale pune me BQK-në. Gjatë praktikës studentet e përzgjedhur do të vendosen nëpër njësi organizative të caktuara të BQK-së dhe do të punojnë nën udhëzimet e mbikëqyrësve të njësisë përkatëse. Në fund të praktikës, studentët do të pajisen me certifikata për kryerjen e programit në fjalë.

Si mund të aplikoni?

Në rend të parë, studentëve u rekomandohet të shikojnë në ueb-faqen e BQK-së dhe të familjarizohen me detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit tonë. Pastaj para se të aplikoni, ju lutemi të lexoni me kujdes aplikacionin për praktikë dhe konform kësaj të përcaktoheni për fushat e interesit ose njësitë organizative të cilat i konsideroni të dobishme për kryerjen e praktikës si:

- Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare;
- Departamenti i Mbikëqyrjes e Sigurimeve;
- Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit;
- Divizioni i Ankesave për Shfrytëzuesit Financiar;
- Divizioni i Parandalimit të Pastrimit të Parasë;
- Divizioni i Mbikëqyrjes Pensionale dhe TLV;
- Departamenti i Administratës;
- Departamentin i Menaxhimit të Mjeteve;
- Departamenti i Sistemit të Pagesave;
- Departamenti i Teknologjisë Informativë;
- Departamenti i Statistikës;
- Divizioni i Regjistrimit të Kredive;
- Divizioni i Rishqyrtimit;
- Departamenti i Planifikimit dhe Raportimit Financiar;
- Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë;
- Departamenti Juridik;
- Departamenti i Stabilitetit Financiarë dhe Analizat Ekonomike;
- Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut;
- Departamenti i Burimeve Njerëzore.

Praktika mësimore në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës mund të kryhet nga studentët të cilët plotësojnë kriteret si më poshtë:

- Të jenë në mbarim të studimeve të larta universitare brenda ose jashtë vendit (preferohet së paku të kenë të mbaruar vitin e dytë); si fakultetin ekonomik ose të ngjashme, juridik dhe shkenca kompjuterike;
- Preferohen studentët me notë mesatare mbi 8;
- Të kenë aftësi për të punuar në grup dhe individualisht;
- Të kenë njohuri shumë të mira të kompjuterit në programet e MS Office (mundësisht me dëshmi përkatëse).

Të gjithë studentët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim për “Programi i praktikës për studentë”;
- CV të detajuar;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për praktike;
- Lista e notave nga universiteti përkatës (në rasti se kandidati vazhdon studimet e larta duhet të ketë listën e notave të gjitha semestrave të përfunduar deri në momentin e aplikimit);
- Një letër referencë nga një pedagog/profesor nga universiteti i përkatës apo rekomandim nga universiteti;
- Kopja e letërnjoftimit apo ndonjë dokumentit tjetër identifikues.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **07 qershor 2023**.
- Aplikimi mund të bëhet përmes postë elektronike në praktika@bqk-kos.org ose të dorëzohet direkt në arkivin e BQK-së, rruga Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPL PËRPARIMI SH.A 1 - VUSHTRRI
Nr. Protokoll: 602/23
Data: 23.05.23

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A, lidhur me nenin 16 nën par. 1.6.2 të Rregullores Nr. 35/23 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A, i miratuar me datë 06.05.2023 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A c duke u bazuar në vendimin me nr. 595/23 të Kryeshefit Ekzekutiv të marr me datë 22.05.2023, N.P.L. "Përparimi" Sh. A me datë 23.05.2023 shpall:

KONKURS PUBLIK

1. Titulli: Mirëmbajtës i Hapësirave Publike

Numri i ekzekutuesve: 6

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar gjashtë (6) muaj, nga të cilat tre (3) muaj do të jenë punë provuese

Përgatitja profesionale: Shkolla fillore

Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes së Hapësirave Publike

Koeficienti i pagës: 4.35

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kujdeset për ruajtjen, pastrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve të qytetit.
- Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e rrethojave të parqeve.
- Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e inventarit për rekreacion dhe pushim në parqe.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e stazave dhe gjelbërimit në parqe.
- Mbjell, kultivon lule dhe bari, si dhe kositë dhe rregullon ato, duke përfshirë ujitjen dhe freskimin.
- Kultivon, mirëmban dhe krasitë drunjtë në pronësi publike.
- Mban higjienën dhe pastrimin e parqeve dhe shesheve.
- Bën hapjen e varrezave.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, martirëve, lapidarëve, përmendoreve, pllakave përkujtimore, të cilat menaxhohen nga komuna.
- Bën fshirjen e oxhaqeve në objektet publike dhe private, në bazë të tarifave të përcaktuara paraprakisht.
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes së Hapësirave Publike.
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është nën hetime dhe të sillet në formë origjinale (jo më e vjetër se 6 muaj);
- Dëshmitë për përvojën e punës (Nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit;

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në Zyrën e Arkivës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 24.05.2023 deri me datë 07.06.2023 në ora 16:00.

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel. 044 - 157 - 075.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPL PËRPARIMI SH.A 1 - VUSHTRRI
Nr. Protokoll: 602/23
Data: 23.05.23

Na osnovu člana 8, člana 10, stav 2.2 i člana 15 Zakona br. 03/L-212 o Radu objavljenog u Službenom glasniku Republike Kosova od 01.12.2010. godine, u vezi sa članom 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o Regulisanju postupaka konkursa u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o Radu, objavljenog u Službenom glasniku Republike Kosova od 31.10.2017. godine, članom 11, članom 21, stav 2.2 i članom 25 Pravilnika br. 55/21 o Radnom odnosu N.P.L. "Përparimi" Sh. A u Vučitrnu, koji je usvojen dana 21.12.2021. godine od strane Upravnog odbora N.P.L. "Përparimi" Sh. A, u vezi sa članom 16, stavom 1.6.2 Pravilnika br. 35/23 o Internoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta N.P.L. "Përparimi" Sh. A, koji je usvojen dana 06.05.2023. godine od strane Upravnog odbora N.P.L. "Përparimi" Sh. A, a na osnovu odluke broj 595/23 Izvršnog direktora dana 22.05.2023, N.P.L. "Përparimi" Sh. A od 23.05.2023 saopštava:

JAVNI KONKURS

1. Naziv: Održavalac javnih prostora

Broj izvršilaca: 6

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Period zaposlenja: Određeno vreme, šest (6) meseci, od kojih će tri (3) meseca biti probni rad

Stručna sprema: Osnovna škola

Radno iskustvo: Nije potrebno radno iskustvo

Podređenost: Rukovodiocu Jedinice za održavanje javnih prostora

Koeficijent plate: 4.35

Opis poslova i odgovornosti:

- Brine o očuvanju, čišćenju i održavanju gradskih parkova.
- Brine o očuvanju i održavanju ograde parkova.
- Brine o očuvanju i održavanju inventara za rekreaciju i odmor u parkovima.
- Brine o održavanju staza i zelenih površina u parkovima.
- Sadnja, gajenje cveća i biljaka, kao i košenje i uređivanje istih, uključujući zalivanje i osvežavanje.
- Gaji, održava i uređuje drveće na javnom vlasništvu.
- Održava higijenu i čistoću parkova i trgova.
- Vršiti otvaranje grobnica.
- Brine o održavanju grobnica za heroje, mučenike, spomenike, memorijalne ploče, koje upravlja lokalna samouprava.
- Vršiti čišćenje jama na javnim i privatnim objektima, na osnovu unapred utvrđenih tarifa.
- Za svoj rad odgovara Rukovodiocu Jedinice za održavanje javnih prostora.
- Vršiti i druge poslove po nalogu uprave preduzeća.

Potrebno priložiti uz prijavu:

- Prijava za zapošljavanje NP "Përparimi" Sh. A - Vučitrn.
- Dokaz o kvalifikaciji (diploma overena kod notara).
- Izvod iz matične knjige rođenih (original).
- Potvrda suda kojom se potvrđuje da nije pod istragom i koja se dostavlja u originalnom obliku (ne starije od 6 meseci).
- Dokazi o radnom iskustvu (nije obavezno).
- Kopija lične karte.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja istog. Zainteresovani kandidati mogu preuzeti i dostaviti prijavi formular u Arhivskoj kancelariji NP "Përparimi" Sh. A u Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" br. 82, (bivši objekat TMK-a pored Osnovnog suda Mitrovica - odeljenje u Vučitrnu), svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji se prijavljuju trebaju tačno navesti adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 24.05.2023. do 07.06.2023. do 16:00 časova.

N.P.L. "Përparimi" Sh. A u Vučitrnu pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosova. Za dodatne informacije možete kontaktirati na broj telefona 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave koje se dostave nakon predviđenog roka neće biti prihvaćene, dok nepotpune prijave će biti odbijene."



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës

01-Nr. 01-016-32884

Me date: 23.05.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr-03/L-040; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031; nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008; në bazë të nenit 4, nenit 10 të Ligji Nr. 03/L-139 PËR SHPRONËSIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me LIGJI Nr. 03/L-205; bazuar në Vendimin me nr. Prot. 01-Nr-464-18639 të datës 18.03.2021 për pranimin formal të kërkesës për shpronësim, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve, Brenda afatit ligjorë, Kryetari i Komunës së Suharekës, mere këtë:

VENDIM PRELIMINAR
(Mbi ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar)

1.SHPRONËSOHET prona private e pronarëve dhe zotuesve të interesit, për interes publik për ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës publike e cila gjindet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116046-01946-0, në sip. prej: 37m² në vendin e quajtur "GRADINA/RRUGA SOPIJES" e evidentuara sipas qertifikatës se pronës në emër të Kryeziu Bajram (Nexhat) 1/3; Kryeziu Rexhep (Nexhat) 1/3; Kryeziu Shaban (Nexhat) 1/3 **ZK. Suharekë.**

2. VERTETOHET se zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës publike në ZK Suharekë është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i paluejtshmëris së lartëcekur do të shërbej për lëvizjen e lire të qytetarëve, është qëllim i ligjshëm dhe në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

3. Vlera e kompenzimit të pronës së cekur në piken 1. të këtijë Vendimi, caktohet nga Ministria e Financave-Zyra e veçant për vlersimin e pronës së paluajtshme, konform Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.03L-139 me ndryshim dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr-03\L-205 për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlersimit qe do të perdorën për përlogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve qe kanë të bëjnë me shpronësimin.

4. Vendimin preliminar, Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, organi shpronësues do t'ia dërgoj zotëruesve të interesit të pronës dhe personave të tjerë të cilët pretendojnë se ju takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Preliminar, organi shpronësues e shpall vendimin në Gazetën zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Rep. Kosovës.

6. Për zbatimin e këtijë Vendimi, obligohet Departamenti për shpronësim në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër .

Arsyetim

Organi shpronësues pas shqyrtimit te kërkesës konstaton se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar si në dispozitiv te këtijë Vendimi Preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtut qëllim dhe se shpronësimi ne fjalë prek të drejtat private, se pjesa e pronës se palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtijë Ligji .

Organi shpronësues-Kryetari i Komunës me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim të paluajtshmerisë Nr. 01 nr.464-18639, dt.18.03.2021 ka miratuar kërkesën e subjektit kërkues-Drejtorisë për Shërbime Publike të Komunës së Suharekës për shpronësimin e pronës së palujtshme për interes publik dhe për ndërtimin e rrugës publike në Suharekë.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkues është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtijë Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtijë Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së Ankesës për kundërshtimin e tijë, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej: 15 ditëve kalendarike pas datës se hyrjes ne fuqi te këtijë Vendimi Preliminar. Në të njejtën ditë në të cilën parashtuesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtuesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejtë të dorëzoj në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për shpronësim).

Vendimi u dërgohet:
Subjektit kërkues
Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe
Arkivit

Kryetari i Komunës :
Bali Muharremaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës

01-Nr. 016-32885

Me date: 23.05.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr-03/L-040; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031; nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008; në bazë të nenit 4, nenit 10 të Ligji Nr. 03/L-139 PËR SHPRONËSIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me LIGJI Nr. 03/L-205; bazuar në Vendimin me nr. Prot. 01-Nr-464-18639 të datës 18.03.2021 për pranimin formal të kërkesës për shpronësim, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve, Brenda afatit ligjorë, Kryetari i Komunës së Suharekës, mere këtë:

VENDIM PRELIMINAR
(Mbi ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar)

1.SHPRONËSOHET prona private e pronarëve dhe zotuesve të interesit, për interes publik për ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës publike e cila gjindet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116046-02789-1, në sip. prej: 50m² dhe, në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116046-02789-6 në sip. prej: 34m² vendin e quajtur "Gradina-Straxhinova" e evidentuara sipas qertifikatës se pronë emër të ELSHANI HALIT (AVDYL), **ZK. Suharekë.**

2. VERTETOHET se zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës publike në ZK Suharekë është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i paluejtshmëris së lartëcekur do të shërbej për lëvizjen e lire të qytetarëve, është qëllim i ligjshëm dhe në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

3. Vlera e kompenzimit të pronës së cekur në piken 1. të këtijë Vendimi, caktohet nga Ministria e Financave-Zyra e veçant për vlersimin e pronës së paluajtshme, konform Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.03L-139 me ndryshim dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr-03\L-205 për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlersimit qe do të perdorën për përlogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve qe kanë të bëjnë me shpronësimin.

4. Vendimin preliminar, Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, organi shpronësues do t'ia dërgoj zotëruesve të interesit të pronës dhe personave të tjerë të cilët pretendojnë se ju takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Preliminar, organi shpronësues e shpall vendimin në Gazetën zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Rep. Kosovës.

6. Për zbatimin e këtijë Vendimi, obligohet Departamenti për shpronësim në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër .

Arsyetim

Organi shpronësues pas shqyrtimit te kërkesës konstaton se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar si në dispozitiv te këtijë Vendimi Preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtut qëllim dhe se shpronësimi ne fjalë prek të drejtat private, se pjesa e pronës se palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtijë Ligji .

Organi shpronësues-Kryetari i Komunës me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim të paluajtshmerisë Nr. 01-Nr.464-18639, dt.18.03.2021 ka miratuar kërkesën e subjektit kërkues-Drejtorisë për Shërbime Publike të Komunës së Suharekës për shpronësimin e pronës së palujtshme për interes publik dhe për ndërtimin e rrugës publike në Suharekë.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkues është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtijë Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtijë Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së Ankesës për kundërshtimin e tijë, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej: 15 ditëve kalendarike pas datës se hyrjes ne fuqi te këtijë Vendimi Preliminar. Në të njejtën ditë në të cilën parashtuesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtuesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejtë të dorëzoj në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për shpronësim).

Vendimi u dërgohet:
Subjektit kërkues
Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe
Arkivit

Kryetari i Komunës :
Bali Muharremaj





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Alzarosa" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues 811894965.

- Agon Stuja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Emrije Vilaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Naim Frasheri " Vlashnje.

- Xhelal Ninaj shpall te pavlefshme dëftesat e lp I - VIII shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

- Erna Jamini shpall te pavlefshme dëftesat shfmu " Fetah Sylejmani " Dragash.

- Enes Konjuhi shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. I-V të shkollës " Nexhmi Mustafa" Besi Prishtinë.

- Bleona Konjuhi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I-V të shkollës "Nexhmi Mustafa" Besi Prishtinë.

- Amanta Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Mentori B.I shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 601640726.

- Afrim Smjali shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani".

- Autoservis Beni-VW AUDI-VAG shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 80273029.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

